
**THE PASTORAL ELEMENT IN THE POEM “CATTLE AND AGRICULTURE” BY
NAIM FRASHERI AND THE POEM “THE SHEPHERD AND THE FLOCK OF SHEEP”
BY JOSIF BAGERI**

Esmije Veseli

University of Tetovo, Faculty of Philology, Albanian Language and Literature, Republic of North
Macedonia, esmije.veseli@unite.edu.mk

Adelina Xhaferi

University of Tetovo, Faculty of Philology, Albanian Language and Literature, Republic of North
Macedonia, adelina.xhaferi@unite.edu.mk

Abstract: The period of the Albanian National Renaissance is one of the most vibrant and important periods in the history of Albanian literature. It brought a new spirit not only in terms of the patriotic cause but also in the realm of various literary creations. This period, among other things, was quite rich in various literary creations, within which the Renaissance writers of the time placed the most beautiful and necessary themes for the Albanian nation. That's why it's no surprise that even the pastoral element appeared among them. This element is quite interesting and remains of ongoing interest to be understood. To this day, it is found in many literary works of the Renaissance, as it presents a homeland through every external or internal element - both constructive and inspirational - bringing today's reader closer to the patriotic flow and spirit of that time. This spirit, in the best way, conveys the flourishing life of a shepherd, the beauty of a land that deserved to be loved, the joyful and constant pursuit of nature's wonders, and at times, even an idealization that the people of that era - in a land endangered, oppressed, and left behind by life - deeply needed. Therefore, by using the method of deduction, as well as literary analysis, this scientific paper will present the way the pastoral element appears in the spiritual and spatial Albania of the time of the Albanian Renaissance writers. At the same time, it will illustrate how this literary element is expressed in its most beautiful poetic form. To convey this idea - to prove the presence of this unique and well-crafted element - two works from the Albanian Renaissance period will be examined: Naim Frashëri's poem and Josif Bageri's poetry.

Keywords: pastoral element, Albanian Renaissance, poem, poetry, homeland

**ELEMENTI BARITOR TE POEMA “BAGËTI E BUJQËSIA” E NAIM FRASHËRIT
DHE POEZIA “BARIA DHE TRUMBA ME DHEN” E JOSIF BAGERIT**

Esmije Veseli

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filologjik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Republika e Maqedonisë së Veriut,
esmije.veseli@unite.edu.mk

Adelina Xhaferi

Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filologjik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Republika e Maqedonisë së Veriut,
adelina.xhaferi@unite.edu.mk

Abstrakti: Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare është njëra ndër periudhat më të zëshme dhe më të rëndësishme në historinë e letërsisë shqipe, e cila solli një frymë të re jo vetëm në aspektin e çështjes atdhetare, por edhe në aspektin e krijimeve të ndryshme të botës së letërsisë. Kjo periudhë, pos tjerave, në vetvete qe mjaft e bujshme edhe me krijime të ndryshme letrare, në brendinë e së cilave rilindësite kohës i vendosën tematikat më të bukura dhe më të nevojshme për kombin shqiptar, ndaj jo më kot në mesin e tyre u pa edhe elementi baritor. Ky element është mjaft interesant dhe në interes të vazhdueshëm njohjeje. Sot e kësaj dite gjendet te shumë letrarë e rilindës, ngase duke e dhënë një atdhe me secilin element të tij të jashtëm a të brendshëm, ndërtues dhe frymëzues, e (për)afro lexuesin e kohës së sotme me rrjedhën dhe frymën atdhetare. Kjo frymë, në mënyrën më të mirë e jep jetën e lulëzuar të një bariu, bukurinë e një toke që duhej dashur, rendjen e vazhdueshme dhe të hareshme drejt bukurive të natyrës, apo herë të tjera edhe një idealizim për të cilin njeriu i kohës, në një tokë të rrezikuar, të shtypur dhe të lënë prapa jetës, kishte shumë nevojë. Ndaj, duke e përdorur metodën e deduksionit, si dhe metodën e analizës letrare nëpërmjet këtij punimishkencor do të paraqitet mënyra se si del elementi baritor në Shqipërinë shpirtërore dhe hapësinore të kohës së rilindësve shqiptarë. Por njëkohësisht do të ilustruhet edhe mënyra se si ky element letrar del në formën më të bukur poetike. Për ta dhënë këtë gjë, për ta dëshmuar praninë e këtij elementi

mjaft të veçantë dhe të gjetur do të shihen dy krijimet e periudhës së Rilindjes Shqiptare, edhe atë: poema e Naim Frashërit dhe poezia e Josif Bagerit.

Fjalët çelës: elementi baritor, Rilindja Shqiptare, poema, poezia, atdheu

1. HYRJA

Periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare është njëra ndër periudhat më të zëshme, më të njohura dhe më të veçanta në historinë e letërsisë shqipe (dhe jo vetëm), “njëra nga epokat më të pasura të trashëgimisë historike dhe shpirtërore të kombit shqiptar”. (Stavileci, 1990, f. 93) Në natyrën e saj rrjedhëse dhe me kapërcime të ndryshme u dalluan zëra të shumtë të krijuesve të kohës, krijimet e të cilëve nuk lidheshin vetëm me një Shqipëri që dukej sipas përmasave dhe hapësirës që kishte, por edhe me një Shqipëri që duhej të mbetej si ëndrrat, dëshirat, përshkrimet dhe himnizimet e vetë rilindësve të saj. Ndaj, jo më kot është theksuar dhe pohuar me kohë se ajo është një “lëvizje që e fillojnë dhe e drejtojnë intelektualët. Shenjat e para të saj, prandaj, më së pari shfaqen në krijimtarinë shpirtërore, posaçërisht në letërsinë, e cila, si aktivitet qendror kulturor i kombit, jo vetëm shënon disponimin që teksta nis të lindë dhe të përhapet në përpjesëtime më të gjera, por, njëkohësisht, e paraprin, gjendjen e ardhshme politike dhe historike”. (Qosja, Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I, 2000, f. 48) Pra, në vetë rrjedhën e saj, në të gjitha aktivitetet me të cilat arriti të ngrihet në këmbë dhe ta shpëtonte një shoqëri të kohës, u dallua mjaft bukur dhe me një natyrë tërheqëse edhe pjesa e letërsisë. Në të, autorët e saj përfaqësues sollën jo vetëm tematika që dilnin nga realiteti dhe bëheshin pjesë e shprehjeve dhe shpërthimeve të bukura artistike, por edhe stile të ndryshme të paraqitjeve të tyre, prandaj është thënë me kohë se, “veçoritë e stilit të krijimtarisë së një shkrimtari gjithmonë kushtëzohen prej përmbajtjeve të trajtuara në veprat e tij dhe prej qëndrimit emocional ndaj tyre. Zgjedhja e përmbajtjeve në masë të madhe kushtëzohet prej botëpërjetimit dhe prej botëkuptimit të tij, në përgjithësi”. (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 273) [sic!] Duke u njohur secila prej tyre, si dhe duke u analizuar brendia e çdo veprë të rilindësve të kohës, duhet përmendur edhe pohimi i thënë me kohë se, “në të gjitha veprat e tyre rilindasit trajtonin tema rreth njeriut të humanizuar, për pozitën e tij në natyrë dhe në shoqëri, rolin e fesë, arsimit, kulturës, në formësimin e qenies gjenerike dhe kalimin prej njeriut të dorës dhe punës në atë të kuptimit dhe të arsyes”. (Sulejmani, 1996, f. 55) [sic!] Në mesin e tematikave të tilla, ajo që ra në sy dhe u duk mjaft e pranueshme për Shqipërinë e asaj kohe që edhe tematika e natyrës, e mbushur në vetvete jo vetëm me simbole dhe elemente të bukura, por edhe me elemente të njëpasnjëshme baritore. Prania e një elementi të tillë do të shihet mjaft qartë edhe në dy krijimet letrare të përzgjedhura për këtë punim shkencor.

2. MATERIALET DHE METODAT

Në qoftë se në morinë e shkrimtarëve përfaqësues të Rilindjes Kombëtare Shqiptare zëri i Naim Frashërit arriti të dalë mbi të gjithë shkrimtarët e kohës, si dhe në qoftë se në hapësirat e Rekës së Epërme fryma e Rilindjes Kombëtare u vu në pah në një mënyrë mjaft të veçantë nga krijimtaria e Josif Bagerit, ky punim, duke e shfrytëzuar si material shkencor veprën e tyre letrare, si dhe duke e përdorur metodën e deduksionit dhe atë të analizës letrare, do ta paraqesë elementin baritor të përfshirë në krijimtarinë e tyre. Do të thotë duke kaluar nga fryma e përgjithshme e letërsisë shqipe gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, te vetë vepra letrare e Naim Frashërit dhe Josif Bagerit, materiali i shfrytëzuar do ta dëshmojë elementin e përzgjedhur për këtë studim, si dhe do ta tregojë mënyrën se si edhe në letërsi mund të kalohet nga e përgjithshmja te një element i veçantë.

3. REZULTATET DHE DISKUTIMET

3.1. ELEMENTI BARITOR TE POEMA “BAGËTI E BUJQËSIA” E NAIM FRASHËRIT

Nëse letërsia shqipe do të duhej të identifikohet me secilën periudhë kohore, do të ishte e mangët nëse nuk do ta kishte në kornizat e vetes së saj, gjegjësisht në kornizat e Romantizmit shqiptar, krijimtarinë letrare/artistike (dhe jo vetëm) të shkrimtarit Naim Frashëri, ngase gjithë rrugëtimi i tij letrar, pavarësisht vendit të veprimit, lidhet me fatin, të ardhmen dhe jetën e Shqipërisë së kohës. Për Shqipërinë është shkruar në vite të tëra e të plota, është shkruar nga autorë të shumtë e të stileve të ndryshme, por kurrë nuk është vënë në pah me një theks të veçantë vetëm një vit i caktuar, siç që në natyrën e letërsisë shqipe viti 1886. Ky vit, pavarësisht se i takonte një numri të madh të rilindësve dhe bashkëkohësve të Naimit, “në shkrimet historike për letërsinë shqipe me të drejtë quhet posaçërisht i rëndësishëm, para së gjithash, për arsye se pikërisht në këtë vit Naim Frashëri boton disa prej veprave të çmuara poetike, shkencore dhe didaktiko-shkollore, ndër të cilat edhe njëren prej veprave të tij më të popullarizuara: poemën lirike, përshkruese baritore, *Bagëti e Bujqësi*”. (Qosja, Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III, 2000, f. 71) [sic!] Kjo poemë baritore, ashtu siç e dëshmon edhe vetë kapërcimi i kohës dhe përmbushja e letërsisë shqipe me vepra dhe tematika të ndryshme letrare, të sjella nga autorë të fushave, interesave dhe kërsërive të ndryshme, i ka rezistuar secilës kohë të re e të panjohur dhe ka arritur që ta bart vlerën e njëjtë edhe në të sotmen. Ndaj, është shumë i drejtë pohimi i thënë më parë se: “Prej pasurisë ideore dhe tematikave të veprave, prej procedimeve sipas të

cilave sendërtohen ato ide dhe tema, prej larmisë gjinore, llojore e nënlojore të krijimeve, prej mundësisë që të merret me fushat e ndryshme të krijimtarisë artistike dhe diturore, prej njohurive të gjera letrare, filozofike dhe shkencore, që dëshmohen në veprat e fushave të ndryshme krijuese - prej të gjitha këtyre shihet qartë se Naim Frashëri është krijues me dhunti të shumëllojshme dhe me kërshëri të gjera në letërsinë shqipe të romantizmit". (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 17) [sic!]

"Sikundër i thot edhe titulli, ajo është një poemë në të cilën këndohen bagëtia dhe bujqësia, shtazëria dhe bimësia e Shqipërisë"(Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 216)[sic!], gjithnjë të idealizuara dhe të himnizuara sipas vargjeve romantike të Naimi Frashërit, botëkuptimi i të cilit është mjaft i veçantë, ngase duke e marrë për subjekt të tij lirik, një bari shqiptar, të vendosur në një hapësirë të atdheut, ai ua bën me dije të tjerëve se, pavarësisht që Shqipëria e kohës ndodhej në gjendje të errët e të rënduar nga pengesat e njëpasnjëshme, çdo element i natyrës së saj, duhej të kthehej në një simbol bukurie dhe përjetësie. Ndaj, jo rastësisht në poemë "paraqitjen e jetës baritore ai e fillon me paraqitjen e bukurisë së tufës së dhenëve, duke vënë në dukje, sidomos, lojën e shqerrave përreth mëmave të tyre. Fjala mëmë në këtë pjesë të poemës - në pjesën për bagëtinë - është aq e theksuar, saqë bëhet simbol që përgjithëson përkushtimin e subjektit poetik ndaj atdheut të tij: mëma këtu bëhet atdheu. Kështu, fjala vjen, vjershëtori e paraqet dashurinë e deles - të mëmës, ndaj qengjit - të birit, ngrohtësinë me të cilën e pret ajo atë, në të vërtetë, duke menduar për dashurinë dhe për ngrohtësinë që ndien njeriu në gjirin e atdheut të vet". (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 219/220) [sic!] Pra, duke i shfrytëzuar simbolet më të bukura të atdheut, të jetës baritore dhe përditshmërisë së tij, Naimi arrin që ta japë te të tjerët porosinë më të nevojshme të kohës, atë të atdhedashurisë. Si romantik i dalluar shihet se poemën e tij e fillon "duke iu drejtuar maleve dhe fushave të Shqipërisë dhe, me këtë rast, duke treguar, sikundër edhe në poemat e njohura të letërsisë së vjetër greke e romake, se për çka do të këndohet në të". (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 217) Ja se si del ky pohim në vargje: "O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë / Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënd dit'enantë / Ju bregore bukuroshe e ju lumënjt'e kulluar / Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar! / Do të këndoj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni / O vëndëthit'e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni."(Frashëri, Bagëti e Bujqësia, 2003, f. 19) [sic!]Pra, duke e lënë vëmendjen te vendasit e kohës së tij, si dhe duke e dashur gjithnjë mbrojtjen e një toke të mirë, të begatë e të mbushur të barinjve dhe bareshave të Shqipërisë, "në poemën Bagëti e Bujqësia, Naim Frashëri shpreh pakënaqësinë dhe shqetësimin shpirtëror të njeriut të tëhuajtur në jetën e qytetit që, për këtë arsye, e idealizon jetën në natyrë:" (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 218) [sic!] Duke e idealizuar dhe himnizuar këtë natyrë, nëpërmjet vargjeve të tij, ai kërkon nga mendja e tij (dhe e të gjithëve) që të jetë dhe të jetojë e lirë në tokën e vënë, me thëllëza, kecër, shqerra, dhen e dhi, trëndafila dhe zogj, si me vargjet në fjalë: "Mëndje, mer fushat e malet, jashtë, nga qyteti / Nga brenga, nga thash-e-themet, nga rrëmuja, nga rrëmeti / Tek këndon thëllëza me gas edhe zogu me dëshirë / E qyqeja duke qeshur bilbili me ëmbëlsirë / Tek hapetë trëndafili, atje ma ka ënda të jem / Bashkë me shpest edhe unë t'ja thërres këngës, t'ja them / Të shoh kedhërit e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhëntë, dhitë / Qiellin e zbukuruar, dhenë me lul' e me dritë". (Frashëri, Bagëti e Bujqësia, 2003, f. 20) [sic!]"Pjesën e parë të poemës Bagëti e Bujqësia, Naim Frashëri e përfundon me një shetitje imagjinare nëpër viset e Shqipërisë, posaçërisht nëpër qytetet më të njohura, duke përkujtuar bukurinë, lashtësinë dhe rëndësinë e tyre. Këtë shetitje imagjinare e shfrytëzon për t'i vënë në dije lexuesit se, tani, pasi e kishte kënduar bagëtinë, do të këndojë edhe bujqësinë". (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 222)[sic!] Do të thotë, "derisa në pjesën e parë, mbi bagëtinë, i këndon bukuritë e shtazërisë e të shpezërisë, si pjesë e natyrës, këtu, në pjesën e dytë, mbi bujqësinë, ai do t'i këndojë bukuritë e bujqësisë: fushat, malet, lumenjtë, arat, livadhet, bregoret, lulet, mëngjeset, mesin e ditës, mbrëmjet verore, njeriun duke punuar në fushë e të tjera". (Qosja, Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III, 2000, f. 211) Ja se si del ky pohim në vargjet e mëposhtme të poemës së Naim Frashërit:"O fushëzatë pëllore që m'ushqeni Shqipërinë / Do të këndoj bukurinë tuaj edhe bujqësinë / Ti Perndi i ligjërisë, që rri në malt të Tomorrit / Nju posht' e më ndih pakë, o motra im' e të gjorit! / Më ke leshrat të floringjta e të ergjëntë kraharorë / Ball' e gush' e faq' e llërë dhe këmb' e duar dëborë / Sindëkur do malësorët dhe pyjet e bagëtinë / Duaj edhe fusharakët dhe arat e bujqësinë." (Frashëri, Bagëti e Bujqësia, 2003, f. 26) [sic!] Në këtë mënyrë del që 'poema "Bagëti e Bujqësia" është një nga veprat më të bukura e më të frymëzuara jo vetëm të Naimit, por edhe të krejt letërsisë së Rilindjes. Askush para Naimit nuk i kishte kënduar dashurisë e mallit për atdhe, krenarisë kombëtare dhe bukurisë së natyrës shqiptare me një patos aq të zjarrtë e me një gjuhë poetike aq të ëmbël e të bukur. Me këtë poemë Naimi krijoi poezinë e madhe të Atdheut e të natyrës shqiptare'. (Frashëri, Bagëti e Bujqësia, Lulet e Verës, Vjersha të tjera, 2010, f. 4)Mbi të gjitha, "kjo poemë, në të vërtetë, në tërësi mund të merret si një apostrofë e natyrës së atdheut: e bagëtisë dhe e bujqësisë së Shqipërisë. Fuqia emocionale e saj, në një pjesë të madhe, është e varur prej qëndrimit të subjektit poetik ndaj natyrës që në të, në përgjithësi, është qëndrim tejet veprues, gjallëruës". (Qosja, Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III, 2000, f. 216/217) Gjithë kjo natyrë që në poemë del mjaft e bukur, me një frymë të veçantë të shpërthimit lirik dhe përshkrimit e thirrjes së elementit baritor, ndihmon të thuhet

se poema në vetvete “është njëra ndër krijimet poetike më spontane, ku shprazet një frymëzim i zjarrtë e i gjerë, që të rrëmben e të hyn thellë në shpirt”. (autorësh, 1989, f. 200) [sic!]. Pra, duke mbetur brenda kornizave të saj poetike, duke u njohur lirizmi i dalë nga thellësia e shpirtit, vlen të përmendet që “botën shqiptare të përshkruar në poemën *Bagëti e Bujqësia*, Naim Frashëri e paraqet në shkallën sipërore, sepse don ta paraqesë të përsosur në të gjitha pikëpamjet. Lumturia aty është lumturi e plotë, e përgjithshme dhe e përhershme; mirësia është mirësi e plotë, e përgjithshme dhe, po ashtu, e përhershme, kurse e bukura është, po ashtu, bukuri e përgjithshme dhe e gjithmonshme”. (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 230) [sic!]

3.2. ELEMENTI BARITOR TE POEZIA “BARIA DHE TRUMBA ME DHEN” E JOSIF BAGERIT

Në morinë e madhe të shkrimtarëve të cilët dallohen në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, me një frymë të veçantë dhe me një punë të vazhdueshme për ta vënë në qendër të vëmendjes historinë e një Shqipërie të kohës, me një interes të vazhdueshëm për ta njohur të kaluarën e saj dhe për ta sjellë në të tashmen çdo element që e ndihmonte ruajtjen e identitetit, në kornizat e kolonive të ndryshme shqiptare të cilat u krijuan dhe funksionuan në hapësira të tjera, jashtë tokës së Shqipërisë, u dallua edhe fryma e Josif Bagerit. Krijimtaria letrare e këtij rilindësi shqiptar, pavarësisht ndërtimit të strofave dhe përzgjedhjes së thjeshtë të vargjeve, pavarësisht formës së përzgjedhur për ta vënë në pah lirizmin e kohës, arriti të njihet dhe të hynte në botën e madhe e të gjerë të letërsisë shqipe me tematika, sa të nevojshme, po aq edhe të bukura për shoqërinë e kohës. Duke qenë se shoqëria e kohës së tillë, e kohës së tij (dhe jo vetëm) qe e detyruar të jetonte dhe të funksiononte e rrudhur çdo ditë e më shumë nga rreziku i armikut dhe i shkeljes së vazhdueshme, apo nga ndikimi i elementeve të huaja; duke qenë se në përbërje të saj binin shumë elemente të bartura, apo të ngjizura në përditshmërinë e së tashmes, duhet përmendur se Josif Bageri, i ndikuar nga puna e shumë rilindësve të tjerë, apo edhe nga vetë nevoja e kohës e krijoi vargun e tij lirik, me mesazhe dhe botëkuptime mjaft të duhura. Ndaj, jo më kot, kur përmenden karakteristikat e rilindësve shqiptarë të kohës, duhet vlerësuar edhe ajo që është thënë me kohë për të, siç del në rreshtat e mëposhtëm: “Josif Jovan Bageri i Rekës së Epërme të Gostivarit, pa mëdyshje është njëri ndër figurat më të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, gazetar e publicist, poet dhe prozator, mendimtar dhe pedagog autodidakt - njëri ndër patriotët më të përmendur në letrat shqipe, i cili tërë jetën dhe veprën e vet ia kushtoi çështjes shqiptare. Ky bir besnik i atdheut, i hapësirës së Rekës së Epërme, poet me shpirt të shqetësuar dhe talent mjaft specifik, lindi, jetoi, punoi dhe veproi në kohën kur Lëvizja Kombëtare e kishte marrë hovin më të madh të zhvillimit të saj dhe pikërisht në kohën kur popullit shqiptar më së tepërmi i nevojiteshin intelektualë dhe atdhetarë të këtillë”. (Abazi, 2009, f. 78) Në këtë mënyrë nga njëra kohë në tjetrën, duke dalë në pah dhe në dritë të botimit secili varg i tij, ashtu si të gjitha elementet e bukura të cilat dukeshin në krijimet e tij, në mënyrë të veçantë u pa edhe elementi baritor. Në këtë të fundit, si në shumicën e penave të rilindësve shqiptarë të kohës, edhe Josif Bageri vendosi që ta vente një bari dhe një tufë të bukur e të dashur delesh. Prandaj, edhe nisja e poezisë së tij “*Baria dhe trumba me dhen*” fillon po me këtë subjekt lirik, duke e vënë frymën e tij dhe lumturinë e madhe në mesin e një tufe dhensh në horizontet e pafundme të maleve shqiptare me erë pranvere. Ja se si del kjo me vargjet e mëposhtme: “Eh, sa i lumtur je njeri! / Me trumb përpara, o bari / Eh, sa mir rron n’at mal me eer: / Ku xbilojn lulat në prëndveer.” (Bageri, 1995, f. 102) [sic!]

Këtë subjekt të veçantë, të bukur dhe të dashur lirik, Josif Bageri e vendos gjithmonë me një tufë të bukur delesh, të cilat, siç përmendet edhe në shumë këngë popullore shqiptare dhe në vepra të tjera letrare, shoqërohen me një melodi të bukur fyelli, bukuria dhe hareja e të cilit vihej në pah dhe merrte një vlerë më të madhe, sidomos atëherë kur lidhej me bukurinë e madhe të bjeshkëve të Shqipërisë. Është pikërisht ky vendi në të cilin autori e vendos subjektin e tij lirik dhe e merr në përditshmëri frymëzimin për të shkruar, pavarësisht se jeta e tij kaloi në koloninë e shqiptarëve të Sofjes (Bullgari), larg fytyrës së vërtetë të atdheut të dëshiruar. Ja se si e thonë vargjet lirike këtë lumturi bariu: “Eh, baria sa mir vishkllen! / Me zarifitin malin po then / Prej kafallit gjumon bjeshka!... / A prej ahit çkulet eshka.” (Bageri, 1995, f. 102) [sic!] Lumturinë e bariut Josif Bageri brenda kësaj poezie e përmendën më shumë se një herë, duke bërë që në këtë mënyrë, lumturia e tij të binte në sy, të besohej nga lexuesi dhe të ndiqej nga rrjedha e kohës së re, pavarësisht se e vërteta e një Shqipërie të kohës ishte tërësisht ndryshme dhe për këtë fajin nuk e mbanin shqiptarët e kohës. Ata, si të tillë, të fshehur prapa zërit të bariut, pavarësisht rëndesës së jetës dhe funksionimit kolektiv, dalin të lumtur dhe të pafajshëm, si më poshtë: “Eh, sa i lumtur je, o bari! / O, sa pa faj, ti je njeri / Shum ngushullohesh, ti në kët jët / Me at trumbën ç’po kullot vet”. (Bageri, 1995, f. 102) [sic!] Pra, duke qenë se këtë element baritor Josif Bageri e njeht mjaft mirë, duhet përmendur që si shumë rilindës të tjerë, atë e mori nga përditshmëria e kohës, siç pohohet edhe më poshtë: “Në vendlindje e kaloi fëmijërinë dhe një pjesë të rinisë. Megjithëse ishte djalosh i zgjuar dhe i zellshëm, për shkak të rrethanave të vështira arsimore nuk pati mundësi që të shkollohet, prandaj si fëmijë u detyrua të bëhet bari”. (Abazi, 2009, f. 78) Nga ky përjetim i tij tashmë del e qartë edhe arsyeja se përse në vargjet e tij lirike, me tone të lehta dhe fjalë të bukura artistike ai e thërrret jetën e një bariu të kohës, prapa të cilit, si në të gjitha lirikat tjera baritore qëndron një natyrë tërheqëse, në të cilën për fat të mirë, apo për fat të keq e humbin kohën duke i ruajtur dhentë dhe dhitë gjithë djemtë dhe vajzat e reja të kohës, siç

shprehet vetë Josif Bageri me fjalët e mëposhtme: “Derën e mësojtores nuk ja dinim ne djelmenit jon: për shkakun se at koh të artë e hupnim tue rujt dhent e dhi në atë mësonjëtoe pa dyer e dritare të natyrës, në ata bjeshkë e male, në të cilat mësonin gjuhën shqipe si bari” (Abazi, 2009, f. 78) I bukur dhe i lehtë në ndërtim të jashtëm, i lehtë dhe tërheqës në përzgjedhjen e fjalëve shprehëse, me një ton të veçantë përshkrues, me një paraqitje të veçantë të botës shqiptare në një tokë të braktisur, me një subjekt lirik, sa të brishtë, po aq edhe të lumtur, edhe vargu i kësaj poezie me motive të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e përqafoi secilën kohë të re, për të arritur deri në ditët e sotme. Vetëm si e tillë ajo e paraqiti një botë të veçantë shqiptare, një shpërthim letrar të brumosur me vetëdije në hapësira të largëta nga një Shqipëri (Rekë e Epërme) e vogël në hapësirë e hartë, por e madhe në zemër.

4. KONKLuzionet

Duke i njohur tashmë të dy krijuesit në fjalë, si dhe duke u mbështetur në natyrshmërinë, larminë dhe ndërtimin e vargut të tyre, mund të pohohet se, pavarësisht rrethanave në të cilat krijuan, vendit në të cilin ia dhanë dritën veprës së tyre, apo herë të tjera, pavarësisht formës së thjeshtë të vargut lirik, krijimtaria e tyre letrare arriti të sjellë një frymë të re në letërsinë shqipe. Të dy figurat e përzgjedhura shihet se prapa vetes kanë lënë një trashëgimi mjaft të pasur letrare, me ç'rast edhe sot e kësaj dite e ndihmojnë vlerën e letërsisë shqipe. Prandaj, është në interes të këtij studimi të theksohet se: “prej veprës së tij mund të shihet qartë se Naim Frashëri është një figurë e gjithanshme dhe gjithanshëm e rëndësishme në letërsinë, në kulturën dhe, në përgjithësi, në historinë e popullit shqiptar. Ai është vjershëtor, por ai është edhe mendimtar, dijetar, pedagog dhe mësues i popullit. Kërshëria e gjithanshme mendore do ta bëjë të gjerë dhe të gjithanshme edhe veprën e tij, në të cilën spikasin shikimet e përpikta të dijetarit, shikimet e gjera të mendimtarit dhe shikimet e thelluara imagjinare të vjershëtorit - të krijuesit racionalist, që botën e njeh me mendje dhe të romantikut, që për botën kallëzon emocionalisht. Dhuntia e gjithanshme i ka bërë të mundshme që letërsisë, kulturës dhe, në përgjithësi, jetës shpirtërore të popullit të vet t’ia sjellë ato që i kanë munguar, ato që më së shumti iu kanë dashur në një periudhë të rëndësishme sikundërse ishte ajo e Rilindjes Kombëtare dhe ato që, mandej, do t’i duhen në periudhat e mëvonshme. Me ato që ka sjellë, por që kanë munguar, ai ka arritur ta çojë përpara jetën arsimore, kulturore, letrare, morale, në tërësi, jetën shpirtërore të popullit shqiptar” (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 557/558) dhe mbi të gjitha, “të jetojë” edhe sot e kësaj dite sidomos me poemën e tij baritore. “Si tërësi, poema *Bagëti e Bujqësia* është ndërtuar në një mënyrë që bën të mundshme të qartësohen plotësisht bukuria dhe pasuria e bagëtisë dhe e bujqësisë së Shqipërisë; por, edhe vargjet, në veçanti, janë ndërtuar në një mënyrë të tillë, që të bëjnë të mundshme të qartësohen plotësisht fjalët, idetë, mendimet dhe ndjenjat, me të cilat ndërtohet ideoemocionalisht tërësia”. (Qosja, Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit, 1990, f. 232/233)[sic!] Duke qenë se “Naimi është themelues i romantizmit shqiptar, vepra e të cilit pasqyron idealet më të larta estetike, ku shkrihet tërë shpirti dhe civilizimi kombëtar” (Sulejmani, 1996, f. 79), duhet përmendur se pavarësisht kapërcimit të kohëve dhe krijimeve të reja letrare, ai do të mbetet njëri ndër rilindësit më të mëdhenj të historisë (së letërsisë) shqiptare. Në vijë të njëjtë me të, sidomos në hapësirat e Rekës së Epërme, hapësirave të Maqedonisë së Veriut, prapa nuk do të mbetet as krijimtaria letrare e Josif Bagerit, ngase, si të gjithë rilindësit tjerë shqiptarë, edhe ky u angazhua për një tokë të lirë, për një subjekt lirik të hareshëm, për një natyrë të kthyer në simbolikë dhe për një element karakterizues për një periudhë letrare. Të gjitha këto pika duke qenë se në veprat e tyre e ndjekin njëra-tjetrën në mënyrën më të mirë, si të tilla, me të gjitha elementet identifikuese dhe trashëguese në rrjedhë të paraqitjes së letërsisë duhet të mbeten të përhershme dhe burime themelore për njohjen e mëtejme të letërsisë shqipe.

REFERENCAT

- Abazi, N. (2009). Poezia didaktike e Josif Bagerit. Tetovë: Ylberi plus.
- Ajdini, A. (2024). Mendimet filozofike dhe pedagogjike në veprat e dy rilindësve Rexhep Voka dhe Josif Bageri. *International Journal of Human Sciences*. Vol. 12. No. 22-23. Pp. 62-65.
- autorësh, G. (2023). Festat kalendarike tradicionale të vitit në Luginë të Preshevës dhe në viset shqiptare. Prishtinë: Lena.
- Autorësh, G. (1989). Historia e letërsisë shqiptare. Prishtinë: Rilindja.
- Bageri, J. (1995). Reka, vendi im. Tetovë: Bashkësia Kulturore Shqiptare.
- Cungu, J., & Ballhysa, A. (2022). Përkushtimi i Bahri Becit për Gjuhën Shqipe. *International Journal of Albanology*, Vol. 9. No. 17-18. pp. 157-162.
- Frashëri, N. (2003). *Bagëti e Bujqësia*. Shkup: Vatra.
- Frashëri, N. (2010). *Bagëti e Bujqësia, Lulet e Verës, Vjersha të tjera*. Tiranë: Reklama.
- Parallangaj, L. (2023). Letërsia dhe arti. *International Journal of Albanology*. Vol. 10. No. 19-20. pp. 312-316.
- Qosja, R. (2000). Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I. Tiranë: BOTIME TOENA.
- Qosja, R. (2000). Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi III. Tiranë: BOTIME TOENA.

- Qosja, R. (1990). Porosia e madhe - Monografi mbi krijimtarinë e Naim Frashërit. Prishtinë: Rilindja.
- Ramadani, Sh. (2023). Language development in children, importance and stages. International Journal of Human Sciences, Vol. 11. No. 20-21. pp. 197-202.
- Stavileci, M. (1990). Iluminizmi në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Prishtinë: Rilindja.
- Sulejmani, S. (1996). Historia e filozofisë shqiptare. Kumanovë: PROSVETA.